# REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PRILL-QERSHOR 2025

| Nr. rendor | Data e kërkesës | Objekti i kërkesës | Data e përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e përfundimit të kërkesës | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 17.03.2025 | Shtëpisë së Libohovitëve, e ndodhur brënda Kalasë së Tiranës | 02.04.2025 | Në vijim të kërkesës Suaj datë 19.03.2022, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, Ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur në link kopje të materialit arkivor per objektin "Ish banesa e Toptanasve", ne rrugen "Myslym Shyri" ne qytetin e Tiranes, per arsye studimor, si dhe pas hulumtimit tuaj pranë Arkivit teknik, përkatësisht si më poshtë:<br>• Skica/rilevime;<br>• Relacione pershkrimore;<br>• Foto historike.<br>Per sa me siper, mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "*Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to*", duke qënë se krijimet grafike dhe fotografike janë objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit, lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur te perdoren dokumentat arkivor.<br>https://www.transferxl.com/it/doënload/080q8JjfNFJmR<br>https://wwwtransferxl.com/it/doënload/08jDg2DbrSpMq7<br>https://www.transferxl.com/it/doënload/08vCXF4YJBSLtJ<br>https://www.transferxl.com/it/doënload/00HjNËqqNPTyX | E plotë | Jo |
| 2 | 08.04.2025 | Në lidhje me denoncimin për punime në Q.H Berat | 09.04.2025 | Instituti Kombetar i Trashegimise Kulturore, ushtron veprimtarine e tij mbeshtetur ne Ligjin nr. 27/2018 "Per Trashegimine Kulturore dhe Muzete", si dhe akteve nenligjore te dala ne zbatim te tij ne fushen e trashegimise kulturore.<br>Nese analizojme kerkasat tuaja rezulton se pervec evidentimit te problematikes qe ju parashtroni ***per kete ndertim, per te cilat jane marre te gjitha masat e duhura deri ne prishjen e ndertimit, dhe per kete te fundit Ju jeni vene ne dijeni,*** Ju pretendoni dhe hidhni akuza mbi | E plotë | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | punonjesit e institucionit apo Drejtorit te Pergjithshem, ne menyre te perseritur, per afera korruptive, apo moszbatim te dispozitave ligjore. Keto pretendime shoqerohen gjithashtu me perdorimin e shprehive nga ana juaj te papershtatshme kundrejt punonjesve te nje institucioni shteteror.<br>Lidhur me keto akuza, drejtuar stafit dhe Drejtorit te Pergjithshem, te perseritura, te pabazuara dhe jashte cdo lloj etike komunikimi, sjellim ne vemendjen tuaj se ne rast perseritjeje te tyre si dhe perdorimit te gjuhes se pahijshme, IKTK brenda kuadrit ligjor, eshte e detyruar te marre masa ne funksion te mbrojtjes se integritetit te institucionit.<br>Referuar faktit mbi vonesen e kthimit te pergjigjes, IKTK ka komunikuar edhe me Drejtorine Rajonale te Trashegimise Kulturore Berat, me qellim perditesimin e situates rast pas rasti. Ne vijim te Vendimit te Keshillit Kombetar te Trashegimise Kulturore Materiale nr. 169, date 13.03.2025, per miratimin e nderhyrjeve plotesuese ne pronen e ____________, ju bejme me dije se punimet nuk kane filluar akoma sipas inspektimit te Drejtorise Rajonale te Trashegimise Kulturore te Beratit.<br>Ne lidhje me vendimin e marre nga KKTKM, ai eshte nje vendim i marre nga nje organ kolegjial vendimmarres (duke respetuar te gjitha hapat e duhura administrative/ligjore si dhe kushtet teknike) dhe IKTK nuk ka kompetence ligjore mbi interpretimin e tyre pervec Gjykates kompetente. | | |
| 3 | 14.04.2025 | Kërkesë për informacion mbi xhamite dhe dokumentacion arkivor nder vite | 14.04.2025 | Në vijim të kërkesës Suaj, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, per arsye studimore Ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur në link kopje të materialit arkivor per objektin "Xhamia e Allajbegise ne qytetin Burim te Dibres," si më poshtë:<br>• Skica/rilevime;<br>• Relacione pershkrimore;<br>• Foto historike.<br>Per sa me siper, mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "*Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to*", duke qënë se krijimet grafike dhe fotografike janë objekt i | E plotë | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | mbrojtjes së të drejtës së autorit, lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur te perdoren dokumentat arkivor.[https://www.transferxl.com/it/doënload/08jZGnY9BX6drm](https://www.transferxl.com/it/doënload/08jZGnY9BX6drm) | | |
| | | | | | E plotë | Jo |
| 4 | 16.04.2025 | Kërkohet Informacion në lidhje me Zonën Mbrojtëse "*Muret Antike dhe Varri i Persqopit*", në kuadër të projektit "*Parku i Besimit*" | 22.04.2025 | Në përgjigje të kërkesës me anë të së cilës, kërkohet informacion në lidhje me Zonën Mbrojtëse "*Muret Antike dhe Varri i Persqopit*", në kuadër të projektit "*Parku i Besimit*" dhe konkretisht:<br>• Aktet ligjore në fuqi për shpalljen e zonës mbrojtëse;<br>• Kufirin e zonës mbrojtëse;<br>• Rregullat që duhen patur parasysh për ndërhyrje në Zonën Arkeologjike B (Zona Mbrojtëse);<br><br>Ju bëjmë më dije se "Muret Antike dhe Varri antik i Persqopit" janë shpallur Monument i Kategorisë së I, sipas vendimit nr. 4874, datë 23/09/1971 dhe zonë mbrojtëse me Urdhrin e Ministrit nr. 44, datë 02/02/2015 të cilët i gjeni bashkëlidhur.<br>Në lidhje me rregullat që duhen patur parasysh për ndërhyrje në Zonën e Mbrojtur, sqarojmë se "Muret Antike dhe Varri antik i Persqopit" nuk kategorizohen si Zonë Arkeologjike B, por referuar vendimit nr. 4874, datë 23/09/1971 për shpallje Monument i Kategorisë së I të "Muri dhe varri antik në Persqop" dhe Urdhrit të Ministrit nr. 44, datë 02/02/2015, bëhet fjalë për Zonën Mbrojtëse të Monumentit të Kulturës të Kategorisë së I.<br>Nëse projekti "*Parku i Besimit*" parashikon ndërhyrje brenda kufirit të zonës mbrojtëse, në bazë të Ligjit 27/2018 "*Për Trashëgiminë Ligjore dhe Muzetë*", nenet 38, 77, 79, 80, kërkesa është objekt shqyrtimi në KKTKM dhe për shqyrtimin e kërkesës në këshillet përkatës pranë IKTK-së është i nevojshëm aplikimi nëpërmjet portalit qeveritar **www.-albania.al**, në kategorinë *"Aplikim për Leje për Ndërhyrje në Pasuri Kulturore Materiale dhe Bonus Rijetësimi"*, sipas linkut: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13702. për shërbimin "Kufirit të Zonës Mbrojtëse të Monumentit". | E plotë | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Në linkun e mësipërm do të gjeni manualin e përdorimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikim.<br><br>Lista e dokumentave për këtë shërbim është si mëposhtë:<br>1. *Deklarata e përgjegjësisë profesionale;*<br>2. *Prokurë autorizim për aplikuesin;*<br>3. *Projektet teknike dhe relacionet përkatëse, në formatin pdf dhe të nënshkruar nga personi fizik/juridik i licencuar në restaurim; (Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e azhornuar të hartës së parcelës-ave; Vendndodhja me koordinata gjeografike; Ortofoto);*<br>4. *Specifikimet Teknike;*<br>5. *Grafiku i punimeve;*<br>6. *Preventiv;*<br>7. *Prezantim Projekti në poëerpoint;*<br>8. *Projekti i plotë në format të editueshëm (AutoCAD, Revit, Archicad, etj.);*<br><br>Bashkëlidhur do të gjeni kopje të shkresës zyrtare nr. 776/1 Prot., datë 22/04/2025 që ju është dërguar me postë, kopje të Vendimit nr. 4874, datë 23/09/1971, kopje të Urdhrit të Ministrit nr. 44, datë 02/02/2015, si dhe linkun që përmban koordinatat dhe gjurmën shapefile të kufirit të Zonës së Mbrojtur.<br>https://www.transferxl.com/doënload/08vCLXg0X97CX7 | | |
| 5 | 28.04.2025 | Kërkohen materiale arkivore për "Banesa e Astrit Dhramit" | 29.04.2025 | Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 "*Për Arkivat*" dhe ligjin Nr. 119/ 2014 "*Për të drejtën e informimit*", Ju informojme se:<br><br>Ne Arkivin Teknik te IKTK-se disponojme dosje teknike dhe dokumentacion fotografik per objektin pasuri kulturore "*Banesa e Astrit Dhramit*", Gjirokaster.<br>Per sa me siper, ne ndihme te hartimit te projektit te restaurimit ju dergojme bashkelidhur ne link kopje digjitale te dokumentacionit te plote arkivor te kesaj banese.<br>Ju informojme se, mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "*Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to*", lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur te perdoren dokumentat arkivor.<br>https://www.transferxl.com/it/doënload/08vLSsV7FRHtk | E plotë | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | 27.04.2025 | Kërkesë për saktësim vendimi, për lejen e ndërtimit në Bashkinë Durrës duke qënë se nga ana e bashkisë nuk më njihet vendimi në formën e lëshuar KKTKM | 29.04.2025 | Referuar Ligjit nr. 27/2018 "Per Trashegimine Kulturore dhe Muzete", Neni 48 "Lejet zhvillimore në zonat e rëndësisë kombëtare të trashëgimisë", percaktohet se:<br>pika 1. Projektet për leje zhvillimore dhe kërkesa për ndërhyrje në zonat e rëndësisë kombëtare të trashëgimisë kulturore miratohen dhe zbatohen në përputhje me dispozitat e ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe këtij ligji.<br>pika 2. Lejet zhvillimore, të rikonstruksionit të ndërtesave dhe ato të infrastrukturës në qendrat historike, zonat arkeologjike A, B, duhet të miratohen fillimisht në KKTKM dhe më pas, sipas legjislacionit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.<br>Bazuar ne percaktimet ligjore te sipercituara, si dhe dhe VKM Nr. 786, datë 26.12.2018 "Per zonifikimin arkeologjik te qytetit te Durresit", IKTK ne cilesine e Sekretarise Teknike te Keshillit Kombetar te Trashegimise Kulturore Materiale (KKTKM), dhe me pas KKTKM, shqyrton dhe vlereson çdo propozim per nderhyrje ne zonat arkeologjike "A" dhe "B" te qytetit te Durresit, duke marre ne konsiderate impaktin e secilit propozim mbi pasurine arkeologjike te zones.<br>Pas cdo shqyrtimi, KKTKM duke vleresuar propozimin mbi bazen ligjore aktuale si dhe ne varesi te shkalles se impaktit mbi zonen arkeologjike, del me vendimin perkates dhe rekomandime nese vleresohet e nevojshme.<br>Sqarojme gjithashtu se, Vendimi i KKTKM eshte nje dokumentacion plotesues dhe nuk eshte leje ndertimi, per te cilen ne rastin tuaj eshte kompetente Bashkia Durres.<br>Sjellim ne vemendje edhe raste analoge, ku me te njejten permbajte te vendimeve te KKTKM, Bashkia Durres ka vijuar me procesin e zbardhjes se lejes se ndertimit, te cilat i gjeni bashkelidhur.<br>Gjithashtu, ju bejme me dije se prane IKTK-se nuk eshte depozituar asnje kerkese zyrtare nga Bashkia Durres, ne lidhje me "paqartesi te mundshme" apo rishikim te pikave, mbi vendime te caktuara nga ana e KKTKM-se. | E plotë | Jo |
| 7 | 02.05.2025 | Kërkesë për informacion mbi procedurën e aplikimit për restaurimin e banesës së vjetër gati 100 vjecare në lagjen nr. 1, Berat. | 05.05.2025 | Në përgjigje të kërkesës suaj dërguar me email në adresën zyrtare të IKTK në datën 02/05/2025, me anë të së cilës kërkon informacion mbi procedurën e aplikimit për restaurimin e banesës së vjetër gati 100 vjecare në lagjen nr. 1, Berat, Ju bëjmë më dije se:<br>Për vlerësimin e kërkesës si dhe për identifikimin e objektit në bazë të VKM-së për zonifikimin, ju lutem të na vendosen | E plotë | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | në dispozicion të dhëna më të detajuara të banesës: zona kadastrale, numri i pasurisë, adresa dhe statusin nëse ka. | | |
| 8 | 05.05.2025 | Kërkesë për marrje materiali teknik nga arkiva e IKTK-së | 06.05.202 | Në vijim të kërkesës Suaj, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" dhe ligjin Nr. 119/ 2014 "Për të drejtën e informimit", Ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur në link kopje digjitake të materialit arkivor per objektin "Kisha e Shen Delliut" (Profet Ilise)", ne lagjen "Kala", Berat si më poshtë:<br>• Skica/rilevime;<br>• Relacione pershkrimore;<br>• Foto historike.<br>Per sa me siper, mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "*Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to*", duke qënë se krijimet grafike dhe fotografike janë objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit, lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur te perdoren dokumentacioni arkivor.<br>https://www.transferxl.com/it/doënload/08yMmZ9r4p6nR | E plotë | Jo |
| 9 | 05.05.2025 | materialit arkivor per objektin "Kisha e Shen Delliut" (Profet Ilise)", ne lagjen "Kala", Berat | | Në vijim të kërkesës Suaj, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" dhe ligjin Nr. 119/ 2014 "Për të drejtën e informimit", Ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur në link kopje digjitake të materialit arkivor per objektin "Kisha e Shen Delliut" (Profet Ilise)", ne lagjen "Kala", Berat si më poshtë:<br>• Skica/rilevime;<br>• Relacione pershkrimore;<br>• Foto historike.<br>Per sa me siper, mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "*Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to*", duke qënë se krijimet grafike dhe fotografike janë objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit, lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur te perdoren dokumentacioni arkivor.<br>https://www.transferxl.com/it/doënload/08yMmZ9r4p6nR | E plotë | Jo |
| 10 | 05.05.2025 | Informacion mbi zbulimet arkeologjike në vendin ku më parë ngrihej Gjimnazi "Gjergj Kastrioti" në Durrës. | 19.05.2025 | Ne lidhje me pyetjet per sa i perket zbulimeve arkeologjike te realizuara gjate rindertimit te shkolles "Gjergj Kastrioti", Durres, sqarojme si vijon:<br>**Përgjigje për pyetjen 1-** Aktualisht, Drejtoria e Shërbimit Arkeologjik në IKTK, po punon për hartimin e dosjes së | E plotë | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | plotë për deklatimin e interest kulturor në lidhje me zbulimet arkeologjike të realizuara në zonën e ish shkollës “Gjergj Kastrioti”, Durrës. Përgatitja e dosjes bazohet mbi dokumentacionin voluminoz të përftuar nga procesi i gërmimit dhe ajo do të shoqërohet me koordinatat përkatëse të zonës mbrojtëse të pasurisë kulturore të propozuar, në përputhje me dispozitat e ligjit 27/2018. Pas përfundimit, dosja do të përcillet pranë KKTKM-së për shqyrtim dhe vendimmarrje.<br>**Përgjigje për pyetjen 2-** Procesi i koservimit të gjetjeve arkeologjike të zbuluara nga gërmimi ende nuk ka përfunduar dhe pas përfundimit do të bëhet kalimi I tyre pranë Muzeut Arkeologjik të Durrësit, konform procedurave ligjore dhe vendimit të KKTKM Nr. 425, datë 25.10.2024.<br>**Përgjigje për pyetjen 3-** Aktualisht pranë Sportelit Unik të IKTK-së nuk ka aplikim për project të ri për rindërtimin e ish shkollës “Gjergj Kastrioti”, Durrës.<br>**Përgjigje për pyetjen 4** – Masat mbrojtëse në lidhje me zbulimet arkeologjike të marra në këtë rast, janë masat standard që merrën pas përfundimit të cdo projekti shkencor të IA ose atyre të shpëtimit, duke mbuluar strukturat arkeologjike me gjeotekstil dhe me dheun e gërmuar. Gjithashtu, për pjesën e mozaikut të zbuluar është kryer konservimi paraprak I tij dhe më pas mbulimi me gjeotekstil. | | |
| 11 | 23.05.2025 | Kërkesë për rishikimin e vendimin e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale | 26.05.2025 | Në përgjigje të kërkesës suaj dërguar me email në adresën zyrtare të IKTK në datën 23/05/2025, për rishikimin e vendimit të KKTKM-së nr. 252, datë 25/04/2025, pasi rezulton se në këtë vendim miratohet kërkesa për vijimin e procedurës së legalizimit për 1 (një) objekt, ndërkohë që dosja e ASHK i referohet 2 objekteve, ju bëjmë me dije se:<br>Pas shqyrtimit dhe vlerësimit nga IKTK, brenda fushës së përgjegjësisë që i ngarkon ligji, të kërkesës për vijimin e procedurës së legalizimit për objektin brenda zonës arkeologjike "A" të qytetit të Lezhës, si dhe të dokumentacionit shoqërues dërguar nga ASHK, KKTKM mori vendimin nr. 252, datë 25/04/2025 për miratimin e kërkesës dhe për vijimin e procedurës së legalizimit për këtë objekt në zbatim të VKM-së nr.1040, datë 25/11/2020 "*Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje*", Kreu II, pika 15, gërma ë).<br>Për sa më sipër, pasi u njohëm me kërkesën tuaj, si dhe duke vleresuar faktin se praktika e ASHK përmban 2 objekte për | E plotë | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | legalizim, Sekretaria Teknike po ndjek të gjitha hapat per korrigjimin e emërtimit në pikën 1 (një) të vendimit të KKTKM-së nr. 252, datë 25/04/2025**:**<br>*"Për 2 (dy) objekte, "Godina shërbimi, 1 (një) kat"*.<br>Ju do të njoftoheni sërish me e-mail si dhe në rrugë shkresore pas korrigjimit të vendimit. | | |
| 12 | 26.05.2025 | Kërkesë për dosje teknike per objektin pasuri kulturore "Kisha e Shen Gjergjit", Shipske | 27.05.2025 | Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 "*Për Arkivat*" dhe ligjin Nr. 119/ 2014 "*Për të drejtën e informimit*", Ju bejme me dije se:<br><br>Ne Arkivin Teknik te IKTK-se disponojme dosje teknike per objektin pasuri kulturore "Kisha e Shen Gjergjit", Shipske, me dokumentacionin arkivor si me poshte vijon:<br>• Rilevime te objektit;<br>• Nderhyrje restauruese nder vite;<br>• Foto historike.<br>Per sa me siper, ju dergojme bashkelidhur ne link kopje digjitale te dokumentacionit te plote arkivor ne ndihme te punes suaj.<br>Mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "*Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to*", duke qënë se krijimet grafike dhe fotografike janë objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit, lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur te perdoren dokumentat arkivor.<br><br>https://www.transferxl.com/it/doënload/08FdMK48YYpTM - Dosja teknike<br><br>https://www.transferxl.com/it/doënload/08H0pmqLycTr2 - Foto historike | E plotë | Jo |
| 13 | 29.05.2025 | Informacion lidhur me trajtimet e projekteve potenciale strategjike te cilat aplikohen ne zbatim te legjislacionit ne fuqi te investimeve strategjike/trashegimia kulturore | 30.05.2025 | Në përgjigje të kërkesës Suaj, për sqarime/saktësime të mëtejshme lidhur me distancën e pasurive të shpallura monument kulture brenda gjurmës së projektit, të ridërguar nga ana juaj me e-mail me datë 29.05.2025,<br><br>Ju informoj se:<br>Nga verifikimi i vendodhjes së zonës, sipas planvendosjes së sipërpërmendur, brenda hapësirës së propozuar për zhvillimin e projektit nuk ndodhen objekte me status | E plotë | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | "monument kulture", "zonë historike" dhe as sipërfaqe me status "zonë arkeologjike" ose "zonë e mbrojtur".<br>Rikonfirmojmë se "Rrënojat e kishës së Shën Ndreut", monument kulture kategoria I, është pasuaria kulturore më e afërt me zonën dhe ndodhet në një distancë prej rreth 197 m larg në vijë ajrore nga zona e parashikuar për zhvillim.<br>Bashkëlidhur gjeni dhe një herë mbivendosjen e zonës së parashikuar për zhvillim, e verifikuar me koordinatat bashkëlidhur kërkesës suaj, në raport me "Rrënojat e Kishës së Shën Ndreut".  | | |
| 14 | 03.06.2025 | Kerkese per material arkivor, si dhe Pasaporten e Monumentit per objektin "KISHA E SHËN MËRISË " ne Laboven e Kryqit. | 11.06.2025 | Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 "*Për Arkivat*" dhe ligjin Nr. 119/ 2014 "*Për të drejtën e informimit*", Ju bejme me dije se:<br><br>Ne Arkivin Teknik te IKTK-se disponojme dosje teknike per objektin pasuri kulturore "Kisha e Shen Merise", ne Laboven e Kryqit, Gjirokaster.<br>Sa me siper, ju dergojme bashkelidhur ne link dokumentacionin e plote arkivor per kete objekt.<br>https://www.transferxl.com/it/doënload/08vYMFDxdXnz0K | E plotë | Jo |
| 15 | 12.06.2025 | Kerkohet dokumentacioni arkivor per Xhamin e GJIN ALEKSIT ne fshatin Rusan, Delvine | 13.06.2025 | Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 "*Për Arkivat*" dhe ligjin Nr. 119/ 2014 "*Për të drejtën e informimit*", Ju bejme me dije se:<br>Ne Arkivin Teknik te IKTK-se disponojme dokumentacion pershkrimor, fotografik dhe teknik të para viteve '90te shek XX, per objektin pasuri kulturore "Xhamia e Gjin Aleksit", Rusan, Delvine.<br>Per sa me siper, ju dergojme bashkelidhur ne link kopje digjitale te dokumentacionit arkivor per objektin ne studim si me poshte:<br>-Foto historike;<br>-Planimetri viti 1977;<br>-Relacione teknike.<br>Mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "*Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to*", duke qënë se krijimet | E plotë | Jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | grafike dhe fotografike janë objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit, lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur te perdoren dokumentat arkivor. https://www.transferxl.com/it/details/08v8QhhnnG7GFQ/ | | |
| 16 | 20.06.2025 | Kerkese per objektin me kod arkivi teknik G 100, me emërtimin Shkolla Goricë, lagjja Goricë, Berat | 25.06.2025 | Nga verifikimi i kryer ne Arkivin Teknik rezulton se nuk disponojme dosje teknike apo dokumentacion fotografik per objektin pasuri kulturore "Shkolla e vjeter e lagjes "Gorice" me kod (G-100), Berat. | E plotë | Jo |